

ERENA HASKA

**KOLEKSIONET HISTORIKE AUDIO-VIZUALE NË SHËRBIM TË
KUJTESËS KOMBËTARE**

Abstrakt

Koleksionet historike audio-vizuale janë pjesë e historisë dhe kujtesës sonë kombëtare. 100 Vjetori i Pavarësisë ishte rasti për të kuptuar më mirë vlerën, dhe shërbimin që këto koleksione kanë për memorien e kombit tonë. Kjo kumtesë do të fokusohet në mënyrën se si këto koleksione duhet të funksionalizohen dhe të bëhen të qasshme nga e gjithë shoqëria jonë, duke na ndihmuar të kuptojmë të shkuarën, me qëllimin, për t'u kujdesur për të ardhmen, por mbi të gjitha duke na ndihmuar të njohim e të promovojmë vlerat tona. Duke pasur parasysh këtë, ky studim mbështetet tezën e përfshirjes së këtyre koleksioneve në rrjetet e kujtesës sonë kombëtare digjitale, sigurisht bazuar në kriteret e përfshirjes në këto rrjete.

Fjalët kyçe: Kujtesa kombëtare, Koleksionet historike, Koleksionet kombëtare, Digjitalizimi, Dokumentimi, Rrjetet kombëtare digjitale

Hyrje

Koleksionet historike filmike që dëshmojnë vizualisht historinë e kombit shqiptar, janë pjesë e koleksioneve të institucioneve arkivore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF) Televizionit Publik Shqiptar (TVSH), Televizionit Kombëtar Top Channel (TCH), Televizionit Kombëtar Klan (Klan), Televizionit Kombëtar Vizion Plus (Vizion Plus) etj., por edhe e koleksioneve të institucioneve arkivore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si Luce, Gaumont Pathe, British Pathe, Library of Congress etj. Fokusi i këtij studimi janë institucionet arkivore audio-vizuale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar arkivat personale.

Ky studim konstaton që: a) kjo pasuri kombëtare nuk është pjesë e rrjeteve kombëtare digjitale, të cilat janë krijuar dhe administruhen me qëllimin promovimin e historisë dhe kulturës kombëtare, b) ky koleksion historik filmik nuk është i përfshirë zyrtarisht në fondin e trashëgimisë kulturore kombëtare¹ dhe c) një pjesë shumë e madhe e koleksioneve historike filmike gjenden në arkivat audio-vizuale nëpër botë.

¹ Elvira Diamanti, *102 vjet në 35mm: dokumentar*, Nëntor 2013 në televizionin Top Channel.

Aktualisht qasja e këtyre koleksioneve historike filmike mund të bëhet vetëm sipas rregullave të institucioneve që i disponojnë, duke e vështirësuar promovimin dhe funksionalizimin e tyre si dokumente të rëndësishme të trashëgimisë kulturore e kombëtare.

Ky studim ka si objektiva: a) të evidentojë rëndësinë e koleksioneve historike filmike si pjesë e rëndësishme e memories dhe koleksioneve kombëtare, b) të mbështesë funksionalizimin e tyre dhe përdorimin nga publiku i gjerë, por në veçanti nga institucionet e mësimdhënies, dhe c) jo më pak e rëndësishme, të mbështesë propozimin e përfshirjes së tyre në “Portalin Albanologjik Shqipëri Kosovë”, duke njohur vlerat dhe informacionin e larmishëm që këto koleksione filmike tregojnë për Shqipërinë dhe shqiptarët ndër shekuj.

Ky studim është bazuar në metodën e kërkimit arkivor. Gjithashtu literatura koherente në fushën e indeksimit, historiografisë e të trashëgimisë kulturore është konsultuar dhe përbën kuadrin teorik të këtij studimi për analizimin e të dhënave empirike të tij.

Koleksionet historike filmike shpalosin vizualisht historinë. Ato janë dritare në të shkuarën, ku historia kalon para syve e gjallë, duke na treguar paraardhësit tanë dhe ngjarjet historike më të rëndësishme që formësuan historinë tonë. Pa dyshim kjo u mundësua në sajë të zbulimit të kinematografisë nga vëllezërit Lumier në vitin 1896 dhe punës së shumë operatorëve e kompanive kinematografike që kaluan në vendin tonë dhe fiksuan në celuloid, jetën e zakonshme të shqiptarëve, doket, zakonet, luftën për liri e pavarësi, figura historike që me vendimet e tyre ndikuan në historinë kombëtare, eksode të shqiptarëve në kushtet e luftës dhe të varfërisë, pushtuesit e huaj që kanë qenë të pranishëm në vendin tonë.

Materialet historike filmike - Pjesë e memories kombëtare.

Materialet filmike komunikojnë me publikun nëpërmjet kombinimit të videos dhe audios, duke ofruar dije, informacion dhe argëtim. Deri në vitin 1960, materialet audio-vizuale kanë qenë totalisht të neglizhuara nga historianët². Në vitin 1961, regjistrimet filmike u pranuan si fakte historike³ e u asimiluan plotësisht në korpusin e burimeve historike dhe mekanizmave të shpjegimit të historisë⁴. Studiuesi pranojnë që integrimi i materialeve filmike në korpusin e burimeve historike dhe trajtimi i tyre si evidenca historike, nuk ishte një zgjedhje e vetë historianëve, por një imponim i bërë nga specialistë jo

² M. Landy, *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, f. 1- 25, England, Rutgers.

³ P. Smith, *The Historian and the film*, 1976, f. 1-15, England, Cambridge University Press.

⁴ P. Smith, *The Historian and the film*, 1976, f. 1-15, England, Cambridge University Press.

historianë⁵. P. Sorlin pohon se një nga arsyt kryesore të këtij ndryshimi është televizioni⁶. Për të kuptuar më mirë këtë zhvillim në vlerësimin e materialeve filmike nga historianët, do të duhet të krahasojmë dokumentet historike me materialin filmik nga këndvështrimi i evidencës historike. Studiuesit mendojnë se nëse historiani dokumentin historik e zbulon, e studion dhe për prezantim të saktë të faktit historik, publikon edhe burimin, në rastin e materialit filmik, historiani nuk zotëron më monopolin e burimit dhe të evidencës historike, por as edhe të studimit dhe të shpërndarjes së tij⁷. Dhe kjo se një media e ka gjetur këtë material historik filmik, e ka shpërndarë si pjesë e prodhimit të saj, duke dëshmuar një vlerë të jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore. Andaj në këtë kontekst të ri, roli i historianit ka ndryshuar, nga ai kërkohet që t'i njohë e t'i shpjegojë këto informacione e të dhëna historike e kulturore që përshfaqen si pjesë e një materiali filmik⁸. Studiuesit pranojnë se avantazhi kryesor i materialit filmik konsiston në mundësinë që ai ofron, *njohjen vizualisht të ngjarjes ashtu siç ka ndodhur, por edhe të figurave historike, pasi një regjistrim filmik është riprodhimi i realitetit dhe është refleksion i kohës, në të cilën është prodhuar*⁹.

Materialet filmike na mundësojnë qasje direkte në histori, e kjo se imazhet historike na paraqiten të gjalla. Por, në krahasim me një dokument të shkruar, imazhet filmike kanë vështirësi për ti kuptuar, si në rastin e materialet filmike pa zë¹⁰ dhe fakt është se në këtë kategori përfshihen, pjesa më e madhe materialeve filmike historike që datojnë shekuj më parë.

Studiuesit mendojnë që materialeve filmike, duhet t'i kushtohet vëmendje leximit të tyre, më shumë sesa thjesht një shikimit të tyre, e gjithashtu, historiani, ose kushdo tjetër që analizon një material filmik, duhet të jetë i aftë të përkthejë këtë sistem me shumë komponent, në një sistem të vetëm, në një tekst me informacionin përkatës, duke përdorur gjuhën¹¹.

⁵ P. Sorlin, How to look an historical film, 2001, f. 20-50, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

⁶ P. Sorlin, How to look an historical film, 2001, f. 20-50, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

⁷ P. Sorlin, How to look an historical film, 2001, f. 20-50, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

⁸ P. Smith, *The Historian and the film*, 1976, f. 1-15, England, Cambridge University Press

⁹ P. Smith, *The Historian and the film*, 1976, f. 1-15, England, Cambridge University Press.

¹⁰ P. Sorlin, How to look an historical film, 2001, f. 20-50, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

¹¹ P. Sorlin, How to look an historical film, 2001, f. 20-50, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

Por cilat janë karakteristikat e një filmi historik dhe cilat janë vlerat e të dhënave historike që mund të mbledhim, duke i analizuar? Duke njohur shumë prej këtyre filmimeve historike, konstatojmë që këto filmime nuk mbulojnë zhvillimet historike të një periudhe të gjatë kohore, ato trajtojnë një fakt ose një ngjarje të vetme, brenda një periudhe të caktuar kohore¹².

J. Grenville¹³ propozon një dallim midis evidencave primare dhe sekondare të një materiali filmik. Le të studiojmë disa prej materialeve filmike të gjetura në arkivat e institucioneve të hulumtuara: a) materiali filmik “Rrethimi i Shkodrës”¹⁴ që daton në vitin 1913. Ky filmim tregon hyrjen e trupave malazeze në Shkodër, shoqëruar nga Esat Pashë Toptani. Në lidhje me ngjarjen historike të pushtimit të Shkodrës nga Mali i Zi, ky material filmik historik jep shumë pak informacione, andaj për një historian ky filmim konsiderohet si evidencë dytësore. Por i njëjti filmim, konsiderohet si evidencë primare nga historianët, se në sekuencat e tij, përshfaqen vizualisht momente historike shumë të rëndësishme që lidhen me këtë ngjarje historike si parakalimi i ushtrisë malazeze në rrugët e Shkodrës, ku midis tyre shfaqet Princi i Malit të Zi dhe vetë Esat Pashë Toptani. Të njëjtin vlerësim merr ky material filmik edhe për sekuencat që tregojnë momentin e ngritjes së flamurit malazez në malin e Taraboshit nga ushtarët malazezë, apo pasojat e bombardimit dhe rrethimit të Shkodrës nga ushtria malazeze b) materiali filmik “Çeta e komitëve shqiptarë”¹⁵, regjistrim që tregon një çetë të luftëtarëve shqiptarë, në vitin 1911, të cilët ngjiten në mal, të veshur me fustanellat tradicionale shqiptare. Ky filmim konsiderohet si një evidencë primare për informacionin që na jep në lidhje me veshjet e luftëtarëve shqiptarë nga krahina e Jugut, në lidhje me mënyrën e organizimit dhe armatimit të tyre etj., e mbi të gjitha, ky është një filmim që tregon shqiptarët në vitin 1911, c) materiali filmik “Eksodi i shqiptarëve”¹⁶ vlerësohet si evidencë primare se dokumenton largimin masiv të shqiptarëve në Veri të

¹² M. Landy, *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, f. 1- 25, England, Rutgers.

¹³ Cituar në G. F. Custen, *Making History*, 2001, f. 50-67, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

¹⁴ Materiali filmik “Rrethimi i Shkodrës 1913” i gjetur në Arkivin Gaumont Pathe, xhiruar nga një operator francez dhe me kohëzgjatje 1minute e 30 sekonda. Ky material filmik gjendet në AQSHF dhe në Arkivin e TCH.

¹⁵ Materiali filmik “Çeta e komitëve shqiptarë”, i gjetur në Arkivin e Televizionit Publik Austriak, ORF me kohëzgjatje 30 sekonda. Ky material filmik gjendet në Arkivin e TCH.

¹⁶ Ky material filmik është gjendur në Arkivin Gaumont Pathe dhe ka kohëzgjatjen 30 sekonda. Ky material gjendet në AQSHF, Arkivin e TCH, Arkivin e Klan.

Shqipërisë gjatë fillimit të Luftës së Parë Botërore, ç) por kur shikojmë planet filmike të ardhjes në Shqipëri të Princ Vidit në vitin 1914, apo, shpalljen e proklamitës së autonomisë së Shqipërisë nën suazën e Perandorisë Italiane nga gjenerali Ferrero në Kalanë e Gjirokastrës në vitin 1917, apo të hyrjes së ushtrisë gjermane në Shqipëri, në vitin 1943, apo largimin e ushtrisë italiane, apo edhe hyrjen në Spidhe të ushtarëve anglezë në vitin 1944, sigurisht këto materiale nga vlera e informacionit historik që ofrojnë, janë evidenca primare historike¹⁷. Por këto materiale historike filmike, dëshmojnë edhe të dhëna që lidhen me kulturën, traditën e veshjeve, zakonet e doket e shqiptarëve.

Ky studim, duke hulumtuar materialet historike filmike që tregojnë për shqiptarët dhe Shqipërinë, konstaton se këto materiale historike filmike, mund t'i krahasojmë me përshkrimet e udhëtarëve që kanë kaluar nëpër Shqipëri dhe kanë treguar për vendin tonë ashtu siç e kanë kuptuar dhe ndjerë, me një ndryshim, që në rastin e materialeve filmike historike, kemi fiksimin e historisë sonë në celuloid e jo në letër, ashtu si operatori apo kineasti i huaj e ka kuptuar dhe ka dashur të na e përcjelli të gjallë sot pas shumë shekujsh, Shqipërinë dhe shqiptarët.

Studiuesit mendojnë se filmimet historike, ndikojnë në njohjen dhe kuptimin më lehtësisht të ngjarjeve historike, pa u imponuar dhe pa deduktimin që ndodh normalisht nëpërmjet një historiani, kur publikon një evidencë historike¹⁸. Në këtë mënyrë, çdo filmim historik, është një indikator i kulturës e historisë së një vendi, duke na shfaqur fakte historike, evidenca të jetës së përditshme, evidenca të shoqërisë, personazhe e figura historike, të regjistruara në celuloid në periudha të ndryshme historike¹⁹, andaj duke dokumentuar fakte historike, fakte shoqërore e kulturore, këto materiale pa diskutim janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore, të cilat duhet të analizohen, e të funksionalizohen nga i gjithë publiku. Historia e kombit shqiptar, e mentalitetit shqiptar, e kulturës shqiptare mund të njihen e të vlerësohen edhe me mirë duke iu referuar këtyre burimeve që kanë prezent komponentin dokumentues, faktografik e ilustrues.

Materialet historike filmike – Funksionalizimi

Arkivat tradicionalisht janë konsideruar si institucione objektive dhe neutrale, ku gjenden të dhëna autentike që lidhen më historinë e kombit, dhe

¹⁷ Arkivat e hulumtuara disponojnë në koleksionin e tyre materiale të shumta të xhiruara nga operatorë të huaj dhe shtëpitë kinematografike nëpër botë. Qëllim i këtij studimi, nuk ishte listimi i tyre, por mënyra për funksionalizimin e tyre, e këtyre materialeve me vlera historike e kulturore.

¹⁸ G. F. Custen, *Making History*, 2001, f. 50-67, në *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, England, Rutgers.

¹⁹ M. Landy, *The Historical Film: History and Memory in Media*, 2001, f. 1- 25, England, Rutgers.

identifikimi i tyre të ndihmon në riprodhimin ose risjelljen e historisë me qëllimin njohjen e saktë të saj²⁰.

Institucionet arkivore në përgjithësi janë institucione që reflektojnë pushtet. Pushteti i institucioneve arkivore konsiston²¹: a) në profesionalizmin e tyre, b) në koleksionimin e dokumenteve historike e kulturore, pavarësisht kostove financiare, c) në funksionimin jo vetëm si institucione ku dokumentet me vlerë historike e kulturore ruhen, por edhe si institucione ku historia dhe kultura kombëtare bëhet publike, d) në konservimin dhe në mbajtjen gjallë të këtij korpusi me vlera të trashëgimisë kulturore e historike, e) në fuqinë për të kontrolluar aktivitetin politik, kombëtar jo vetëm të figurave historike e politike por edhe qeverive, duke mundësuar për qytetarët transparencën në çështje të ndryshme që lidhen me ta, f) në diversitetin e koleksioneve dhe shërbimeve që ofrojnë, g) në përdorimin dhe qasjen e materialeve arkivore nga përdoruesit.

Cituar edhe më sipër, koleksionet historike në territorin e Republikë së Shqipërisë administrohen nga AQSHF e TVSH në nivel publik dhe nga arkivat e televizioneve kombëtare e private. Këto arkiva kanë në koleksionin e tyre, materiale filmike me vlera historike e kombëtare. Në sajë të përdorimit të teknologjisë së informacionit, që është shumë e avancuar në këto institucione arkivale, këto materiale në pjesën më të madhe të tyre, janë të digjituara.

Arkivat në Shqipëri aktualisht po funksionojnë si institucione të rëndësishme të prodhimit të historisë dhe të promovimit të kujtesës dhe të identitetit kombëtar, duke na ofruar mundësitë të kuptojmë dhe të reflektojmë për çështjen shqiptare që edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të qëndrojnë në rend të ditës të kombit shqiptar dhe pas pavarësisht të Kosovës²².

Nga hulumtimi, rezulton se arkivat audio-vizuale kanë punuar për funksionalizimin e këtyre materialeve, në tre drejtime: a) në ruajtjen, restaurimin dhe prezervimin e koleksioneve historike filmike. Rezultati i këtij objektivi është kalimi i këtij koleksioni nga formate analoge në formate digjitale, duke mundësuar kështu krijimin e arkivave digjitale institucionale (AQSHF, TCH, Klan, Vizion Plus, TVSH), por edhe krijimin e arkivave digjitale të aksesuara në distancë nga publiku (AQSHF), b) të gjitha arkivat e hulumtuara kanë një shërbim dokumentimi (AQSHF, TCH, Klan, Vizion Plus, TVSH) që është përgjegjës për administrimin e kësaj pasurie intelektuale, kulturore e historike. Pjesë e administrimit është edhe përpunimi shkencor i

²⁰ R. C. Jimerson, Archives and manuscripts, archives and memory në *Oclc System & Services*, 19, 3, 2003, f. 91.

²¹ Mark A. Greene, *The Power of Archives: Archivists' Values and Value in the Post-Modern Age*, 2009, p. 1-13.

²² Sh. Murati, *Çështja shqiptare pas Pavarësisë së Kosovës: një testament diplomatik*, Tiranë, 2009, f. 46.

materialeve arkivore dhe c) përdorimi i koleksioneve historike filmike në prodhimet e dokumentarëve, me qëllim njohjen e tyre nga një publik më i gjerë.

Megjithatë fuqia dhe pushteti i një institucioni arkivor nuk qëndron vetëm në koleksionin që disponon, por dhe në mundësinë për ta bërë këtë koleksion të komunikojë me publikun dhe të jetë i qasshëm prej tij²³. Ky studim konstaton se pavarësisht përpjekjeve të institucioneve arkivore të hulumtuara për të funksionalizuar koleksionet historike kombëtare që disponojnë, këto përpjekje nuk janë të mjaftueshme. Këto koleksione duhet të trajtohen nga institucione kombëtare që administrojnë trashëgiminë kulturore, që promovojnë kulturën, historinë e kombit, jo vetëm për mundësinë e njohjes së historisë vizualisht, por edhe për funksionalizimin e tyre në mësimdhënie, për më shumë dije dhe njohuri nga shqiptarët e tanishëm, por edhe brezat e ardhshëm.

Materialet historike filmike – Përfshirja e tyre në Kujtesën digjitale kombëtare

Biblioteka Kombëtare grumbullon, pasuron, përpunon, ruan dhe vë në shërbim të përdoruesve botimet në gjuhën shqipe, si dhe botime në gjuhë të huaj që përmbajnë informacion për Shqipërinë dhe kombin shqiptar dhe përbëjnë koleksionin albanologjik²⁴ dhe është qendër e restaurimit të materialeve bibliotekare që klasifikohen si trashëgimi kombëtar kulturor dokumentar²⁵.

Pavarësisht se ky nen i referohet vetëm botimeve, sugjerimi i këtij studimi është që edhe materialet historike filmike, duhet të konsiderohen nga autoritetet shtetërore si trashëgimi kulturor dhe të marrin këtë status që përfundimisht do tu japë të drejtën e hyrjes së tyre në rrjetet kombëtare digjitale të kujtesës kombëtare që administrohen nga bibliotekat kombëtare, respektivisht në Shqipëri dhe Kosovë. Por edhe në pritje të rishikimit të këtij neni të ligjit, pikërisht detyrë e institucioneve bibliotekare kombëtare është bashkëpunimi me institucionet shtetërore ose private që administrojnë pasuri kombëtare me qëllim përfshirjen e tyre dhe të dokumenteve që disponojnë pavarësisht formatit, në projektin “Portali Albanologjik Shqipëri Kosovë”. Ky studim propozon këtë nisur edhe nga ideja e krijimit të një projekti kombëtar “Kujtesa Kombëtare” që do të përfshinte gjithë dokumentet për shqiptarët dhe Shqipërinë, ide që u formësua në Konferencën kombëtare të Bibliotekonomisë “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”, mbajtur në Kosovë në vitin 2007.

²³ Po aty.

²⁴ Ligji për biblioteka nr. 8576, datë 3.2.2000 *Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë*, neni 27, pika 2.

²⁵ Ligji për biblioteka nr. Nr. 8576, datë 3.2.2000 *Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë*, neni 27, pika 11.

Në fjalën përshëndetëse të kësaj konference shkencore, profesori S. Bashota, pohon” *“Kujtesa Shqiptare, doemos, do të kenë rolin kryesor në grumbullimin, seleksionimin, sistemimin dhe digjitalizimin e materialeve të veçanta, për t’iu ofruar lexuesit një qasje të lirë në botën e internetit, sidomos për të kaluarën dhe të ardhmen e shqiptarëve, nëpër periudha të ndryshme historike... përparësi do të kenë materialet me vlerë të veçantë dhe unikate nacionale, që do ta dokumentonin lashtësinë, gjuhën, identitetin, qytetërimin, kulturën etj.”*

Në këtë konferencë u vendos që: a) koleksioni digjital kombëtar të përshinte historinë gojore, vizuale e të shkruar të kombit shqiptar, brenda vendit dhe jashtë Shqipërisë dhe b) drejtimin dhe rolin më i rëndësishëm në këtë projekt kombëtar do ta kishin Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë dhe Biblioteka Kombëtare e Kosovës.

Nisur nga serioziteti dhe rëndësia që ky projekt kishte, për dy institucionet më të rëndësishme bibliotekare të kombit, ky projekt u realizua nën kujdesin e profesor Aurel Plasarit dhe profesor Sali Bashotës në Tiranë më 5 Mars 2011, në ambientet e Bibliotekës Kombëtare, ku edhe u nënshkrua marrëveshja për realizimin e këtij projekti²⁶. Kjo marrëveshje zyrtarizoi krijimin e portalit albanologjik për gjithë kombin që është një shërbim pa pagesë, e që ofron informacion të larmishëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, ku vend të veçantë zënë burimet bibliografike dhe koleksionet e digjituara të trashëgimisë kulturore kombëtare²⁷. Nëpërmjet tij mundësohet kërkimi dhe qasja në vlerat e rralla të trashëgimisë kombëtare në çdo kohë, nga kudo dhe nga kushdo²⁸.

Nisur nga misioni që portali albanologjik ka, pra promovimi i trashëgimisë kulturore kombëtare dhe qasja e saj në rrjetet globale të komunikimit, mision, që mund të zgjerohet edhe nëpërmjet bashkëpunimit me arkivat audio-vizuale, me qëllimin përfshirjen në këtë platformë, edhe të materialeve me vlerë historike, kulturore e albanologjike për kombin në formatin video dhe audio. Eksperiencat botërore kanë treguar se funksionalizimi i materialeve që gjenden në institucionet arkivore e bibliotekare, materiale që janë pjesë e trashëgimisë kulturore, mund të konsiderohet i suksesshëm, nëse këto materiale bëhen të qasshme nga publiku i gjerë, brenda dhe jashtë vendit, e përdoren për zhvillimin e dijeve dhe të

²⁶ Informacion i marrë nga faqja zyrtare e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë http://www.bksh.al/Te%20reja_ngjarje58.html

²⁷ Informacion i marrë nga faqja zyrtare <http://www.portialalbanologjik.org/historik.html>

²⁸ Informacion i marrë nga faqja zyrtare <http://www.portialalbanologjik.org/historik.html>

njohurive. Ky funksionalizim duhet të realizohet në nivel profesional dhe kombëtar, me rezultat krijimin e një biblioteke virtuale për kombin.

Ky studim, pavarësisht konstatimit të përpjekjeve individuale të institucioneve arkivore për funksionalizimin e materialeve historike filmike, sugjeron që materialet historike filmike që tregojnë për Shqipërinë e shqiptarët në shekuj të jenë pjesë e “Portalit Albanologjik Shqipëri Kosovë”. Arsyet që ky studim mbështet këtë propozim janë: a) materialet filmike janë asete të trashëgimisë kulturore, se dëshmojnë historinë dhe kulturën kombëtare, b) promovim më i kujdesshëm dhe i kultivuar i kulturës dhe historisë, c) mundësia për funksionalizimin e tyre në dije dhe në mësimdhënie dhe qasje të barabartë, d) njohja e kulturës e historisë kombëtare dhe diversitetit kulturor shqiptar, e) krijimi i një biblioteke virtuale për kombin f) profesionalizimi dhe ekspertiza e dy institucioneve bibliotekare kombëtare në administrimin e koleksioneve të trashëgimisë kulturore, g) misioni që këto institucione kombëtare kanë, d) fakti që këto dy institucione kanë krijuar një portal të njësuar për kulturën dhe historinë e kombit shqiptar që do të mundësonte një qasje one stop shop, pra kërkim, gjetje dhe qasje direkt të koleksioneve kombëtare (dokumente apo materiale audio-vizuale), nëpërmjet një ndërfaqeje të unifikuar për përdoruesit brenda dhe jashtë vendit, gj) përfshirja e këtyre materialeve në këtë portal do të përbënte një vlerë të shtuar në rrugën për promovimin e trashëgimisë kulturore e historike dhe sigurisht do të mundësonte realizimin e objektivit të këtij portali për të qenë pika e qasjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për cilido që është i interesuar, individ ose institucion të njohë e të përdorë dokumentet arkivale mbi historinë e kulturën e kombit shqiptar²⁹.

Përfundimet

Ky studim konkludon në këto pika a) domosdoshmëria për të pasur një bibliotekë virtuale, ku e gjithë historia e kultura kombëtare të promovohet me qëllim njohjen dhe funksionalizimin e plotë të saj. Guri i parë i themelit shumë të fortë e të rëndë është hedhur nëpërmjet “Portalit Albanologjik Shqipëri Kosovë”, kështu që është detyra e të gjitha institucioneve shqiptare private e shtetërore që të kontribuojnë në pasurimin e tij, me koleksione dokumentare por edhe me koleksione filmike që dëshmojnë historinë e shqiptarëve dhe të Shqipërisë, b) koleksionet historike filmike dëshmojnë kulturën dhe historinë kombëtare dhe duhet të vlerësohen nga institucionet zyrtare pjesë e trashëgimisë sonë kombëtare dhe c) funksionalizimi i koleksionit historik

²⁹ Objekt i këtij studimi nuk është mënyra praktike e realizimit të përfshirjes së këtyre koleksioneve në këtë portal dhe as ndërveprimi midis platformave të ndryshme digjitale të këtyre institucioneve, pasi kjo do të kërkonte një studim të thellë.

filmik për dije do të ishte një investim për shqiptarët e sotëm dhe brezat e ardhshëm.

BIBLIOGRAFI

- Amad, P., (2010). *Counter Archive: Film, the everyday, and Albert Kahn's Archives de la Planete*. New York: Columbia University Press.
- Dibbets, K., (2010). Cinema context and the genes of film history. *New Review of Film and Television Studies*, 8, 3. f. 331-342.
- Greene, M. A., (2009). *The Power of Archives: Archivists' Values and Value in the Post-Modern Age*. F. 1-13. I tërhequr më 25 dhjetor 2012 nga <http://www2.archivists.org/sites/all/files/GreeneAddressAug08.pdf>.
- Ketelaar, E., (2008). Archives as Spaces of Memory. *Journal of the Society of Archivists*, 29, 1. f. 9-27. DOI: 10.1080/00379810802499678.
- Islamaj, O. (autor), (Nëntor 2013), *102 vjet në 35mm film: dokumentar*. Tiranë: Televizioni Kombëtar Top Channel.
- Jimerson, R. C. (2003). Archives and manuscripts, archives and memory. *Oclc System & Services*, nr. 19, vol. 3. Marrë nga Emerald dt. 4 Dhjetor 2013.
- Landy, M., (editor). (2001). *The Historical Film: History and Memory in Media*, England, 2001.
- Ligji për biblioteka Nr. 8576, datë 3.2.2000 Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë, neni 27, pika 2
- Murati, Sh. (2009). Çështja shqiptare pas Pavarësisë së Kosovës: një testament diplomatik. Tiranë: Globus R.
- Paulus, M. J., (2011). The converging Histories and Futures of Libraries, Archives and Museums as seen through the case of curious collector Myron Eells. *Library & the Cultural Record*, 46, 2.
- Puto, A. (2009). *Shqipëria politike 1912 – 1939*. Tiranë: Toena.
- Randall, C. J., (2003). Archives and Memory. *OCLC Systems & Services*, 19, 3. F. 89-95. Doi: 10.1108/10650750310490289.
- Russell, W. B., (2012). The Art of Teaching Social Studies with Film. *The Clearing House*, 85. f. 157-164. DOI: 10/80/00098655.2012.674984.
- Smith, P., (1976). *The Historian and the film*, England: Cambridge University Press.